



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 9895 prot.

Tiranë, më 22.12.2022

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 9895, datë 22.12.2022

“MBI ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË “ALBGAZ” SH.A”

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 135, 145, 168 e në vijim të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), VKM nr.848, datë 07.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a dhe për caktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë Albpetrol sh.a dhe Albgaz sh.a” (i ndryshuar), Statutin e shoqërisë, Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” (i ndryshuar), në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Albgaz” sh.a,

VENDOSA:

1. Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të shoqërisë “Albgaz” sh.a në shumën prej 1,200,000,000 (njëmiliard e dyqind milion) lekë.
2. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë me para do të kryhet nëpërmjet emetimit të 1,200,000 aksioneve të reja me vlerë nominale 1000 lekë për aksion, të cilat janë të barabarta në çdo aspekt me aksionet ekzistuese dhe së bashku me to përbëjnë aksionet në kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Kapitali Themeltar i shoqërisë pas zmadhimit bëhet 1,697,499,000 (njëmiliard e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatëmilion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë) lekë i barabartë me 1,697,499 aksione me vlerë nominale 1000 lekë për aksion.
4. Ngarkohet Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kryejnë transaksionin financiar për zmadhim kapitali themeltar në vlerën 1,200,000,000 (njëmiliard e dyqind milion) lekë, në favor të shoqërisë “Albgaz” sh.a.

5. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “Albgaz” sh.a, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Belinda Balluku

